



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 30.01.2023, Nr. 09-AAA/01-5782



Në bazë të nenit 64 pika 1, 68 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtares Publike të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Udhëzimit Administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtori për Arsim në Drenas, shpallë:

K O N K U R S

1. QEAP "Ardhmëria" – Drenas III (Çikatovë e Re).

- Pesë (5) Edukatore, me kohë të pacaktuar.

Punët dhe detyrat për Edukator/e

1. Edukatorja realizon direkt punën edukativo-arsimore me fëmijët të moshës 3-6vjeç
2. Përgatit dhe planifikon punën vjetore, mujore, javore dhe ditore me qëllim të realizimit të detyrave programore.
3. Planifikon aktivitete ditore me fëmijë ,si takimet e mëngjesit, nëpër qendra të aktivitetit, aktivitete të lira (shfrytëzimin e faktorit natyror) si dhe aktivitetet e pasdites.
4. Organizon pranimin e fëmijëve në mëngjes si dhe përcjelljen e tyre, përgjegjëse është për sigurimin fizik të fëmijëve, mirëpret me ngrohtësi si dhe ofron përjetimin e sigurisë.
5. Punon në kultivimin e shprehive të punës, shprehive kulturore-higjienike, shprehive pushim aktiv (gjumë) veshjes - në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që i shtron Kopshti.
6. Të inkurajohet fëmijëve zhvillimi gjuhësor dhe komunikimeve tjera për përdorimin efikas dhe kreativ të gjuhës, që më vonë të ndihmoj në lexim dhe shkrim,
7. Të inkurajohet fëmijëve aftësia dhe shprehja artistike, zhvillimi fizik, higjiena personale dhe në kujdesin e shëndetit të tyre.
8. Planifikon ,organizon dhe realizon programin e bashkëpunimit me komunitetin.
9. Merr pjesë në planifikimin dhe sigurimin e materialit didaktik për punën edukativo –arsimore.
10. Mban dhe evidenton me kohë dokumentacionin pedagogjik, në realizimin e detyrave programore.
11. Merr pjesë në punën e organeve ,këshillave, tubimeve profesionale.
12. Merr pjesë aktive në veprimtarit kulturore të institucionit (programe ekspozitë, manifestime)
13. Sistematikisht punon në ngritjen e vetë profesionale (përcjell literaturën profesionale, merr pjesë në trajnime ,seminare dhe aktive profesionale).
14. Kryen punën e mentorës (në raste se caktohet për këtë detyrë)

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vëndet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05 / 2021-MASHT.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik (vula orgjinale, jo në kopje).
4. Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
5. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur më çështjen e punësimit, për kandidatët që pranoen në punë.

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim, me gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të bëjë Komisioni i përzgjedhur nga Njesia e Burimeve Njërzore.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-s,të plotësohet rrjedhshëm në Gjuhën Shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentët e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shitesë jashtë afatit të dorëzimit në arkiv nuk pranoen, dhe dukumentacionet e dorëzuara për aplikim nuk kthehen.

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data **01.03.2023 deri 15.03.2023**.

Njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen zyrtare të Komunës së Drenasit dhe në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net>.

Drenas,
Më:30.01.2023



Drejtore për Arsim

Muhamet Gjoka